

## UNTHEMATIC AND THEMATIC CONJUGATION OF PRESENT SUBJUNCTIVE AGAINST IN FRONT OF PRESENT INDICATIVE

Agnesa Hasimja – Pasha

University of Prishtina “Hasan Prishtina”, Kosovo, [agnesahasimja@uni-pr.edu](mailto:agnesahasimja@uni-pr.edu)

**Abstract:** The main verb moods of Albanian (language) are, in fact, inherited from an early Indo-European period. However, during its evolution, this language has further developed its modal contradictions (Demiraj, 2015). Many moods have vanished in many Indo-European languages, but there are also recreations. There are formations of Albanian (language): -Optative, according to Pedersen is an “aorist of subjunctive”; admirative mood is a creation of Albanian (language), which during its historical evolution has created also some verb forms (Demiraj, 1988). Also about subjunctive mood, Çabej (1986) says that it contains inherited elements, but it is also a recreation. He takes as an example the verb *shkoj* (to go), and makes the comparison in indicative and subjunctive mood: *shkoj* (to go), in indicative mood *unë shkoj* (I go), *ti shkon* (you go), *ai shkon* (he goes); *ne shkojmë* (we go), *ju shkon* (you go), *ata shkojnë* (they go); in subjunctive mood *unë të shkoj* (I go), *ti të shkosh* (you go), *ai të shkojë* (he go); *ne të shkojmë* (we go), *ju të shkon* (you go), *ata të shkojnë* (they go). So, only the second and the third person of singular differ, whereas the other four are the same. Therefore, the duty of this research is to make a presentation of studies in this field of the history of language, in order to make a clear distinction of the unthematic and thematic conjugation of the present tense of subjunctive mood against the present tense of indicative mood.

**Keywords:** conjugation, present tense, subjunctive mood, indicative mood

## ZGJEDHIMI ATEMATIK DHE TEMATIK I SË TASHMES SË LIDHORES KUNDRUALL SË TASHMES SË DËFTORES

Agnesa Hasimja – Pasha

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Kosovë, [agnesahasimja@uni-pr.edu](mailto:agnesahasimja@uni-pr.edu)

**Abstrakt:** Mënyrat foljore kryesore të shqipes janë, në thelb, të trashëguara nga një periudhë e hershme i.e. Por gjatë evolucionit të saj kjo gjuhë i ka zhvilluar më tej kundërvëniet modale (Demiraj,2015). Shumë mënyra janë zhdukur në shumë gjuhë indoevropiane, po ka edhe rikrijime. Janë formacione të shqipes: -dëshirorja, sipas Pedersenit është një “aorist i lidhores”; habitorja, është një krijim i shqipes, që gjatë evolucionit të saj historik ka krijuar edhe disa forma foljore (Demiraj,1988). Edhe për lidhoren, Çabej (1986) thotë se përmban elemente të trashëguara, po është njëkohësisht edhe rikrijim. Ai e merr si shembull, foljen *shkoj*, dhe e bën krahasimin në dëftore dhe lidhore: *shkoj*, në dëftoren *unë shkoj*, *ti shkon*, *ai shkon*; *ne shkojmë*, *ju shkon*, *ata shkojnë*; në lidhoren *unë të shkoj*, *ti të shkosh*, *ai të shkojë*; *ne të shkojmë*, *ju të shkon*, *ata të shkojnë*. Pra, vetëm veta e dytë dhe e tretë e njëjësit dallohen, përndryshe katër të tjerat janë njësoj. Domethënë, sipas Çabejt, erdhi një periudhë e shqipes ku këto dy mënyra u pucën në format e tyre. Prandaj, detyrë e këtij hulumtimi është që të bëhet një pasqyrim i studimeve në këtë fushë të historisë së gjuhës, për të bërë një dallim të qartë të zgjedhimit atematik dhe tematik të kohës së tashme të mënyrës lidhore kundruall kohës së tashme të mënyrës dëftore.

**Fjalët çelës:** zgjedhimi, e tashmja, lidhorja, dëftorja.

### 1. HYRJE

Format e së tashmes së lidhores të foljeve të zgjedhimit në *\*/-mi/* dallohen nga format gjegjëse të së tashmes së dëftores jo vetëm nëpërmjet pjesëzës *të*, por pjesërisht edhe nëpërmjet temave dhe mbaresave vetore (Demiraj,2015). Ndërsa Topalli (2005) shton se ndryshimet ndodhin më shumë në numrin njëjës.

Folja *jam* në të gjithë paradigmen e së tashmes së lidhores del me temën burimore *je-* < *\*es-*, pra, edhe në vetën e tretë njëjës, ku ajo ndryshon dukshëm nga forma gjegjëse e dëftores *është* - *të jetë*. Dalja e temës *je-* në të gjithë paradigmen e së tashmes së lidhores, sipas Demirajt (2015), duhet kërkuar në prirjen relativisht të vjetër të gjuhës shqipe për t'i rrafshuar ndryshimet në temën e kësaj forme kohore. Nga ana tjetër, format e kohës së tashme të lidhores të foljeve *kam* e *thom*, sipas tij, janë riorganizuar nën ndikimin e formave gjegjëse të foljes *jam*. Ai përmend këtu formën *të ketë* (sipas *të jetë*) përkundrejt formës *ka* të së tashmes së dëftores.

Mbaresat vetore të së tashmes së lidhores të foljeve të zgjedhimit në *\*/-mi/*, në përgjithësi, janë të njëjta me ato të së tashmes së dëftores. Të vetmet përjashtime janë: 1) prania e mbaresës së vetës së dytë njëjës */-sh/* (*khs. je ~ të jesh, ke ~ të kesh, thua/thue ~ të thua-sh/të thue-sh*); 2. shtrirja analogjike e mbaresës */-të/* te *ke-të*, sipas *të je-të*.

Sipas Demirajt (2015), edhe e tashmja e lidhore e foljeve të zgjedhimit në \*/-ō/, \*/-jō/ dallohet nga ajo e dëftores jo vetëm nëpërmjet pjesëz të, por edhe nëpërmjet mbaresave të vetës së dytë e të tretë njëjës e në disa raste edhe nëpërmjet temës, si p.sh. të hap, të hap(ë)sh, të hapë, të hapim, të hapni, të hapin (hap), dal, mat ose mas, flas, hyj, vë, bie, di.

Pra, foljet e mësipërme në vetën e dytë njëjës të së tashmes së lidhore marrin mbaresën /-sh/, e cila, e ka burimin te mbaresa vetore i.e. \*/-si/ (Demira,2015). Topalli (2005) vëren se mbaresa –sh e vetës II njëjës te Buzuku del edhe në formën –ç; p.sh.: E të jeç grishunë forcuousi i d renuomit, e atje të jeç, e ta gëzoinsh e të jeç mbrenda. Kjo mbaresë nuk është krijuar me rrugë fonetike, sepse shndërrimi i fërkimores në afrikate (/sh/ > /ç/), që është dukuri e disa të folmeve të Jugut, nuk është tipike për këtë shkrimtar. Prandaj ajo është përfutur me rrugë analogjike sipas foljeve që dalin me një mbaresë të tillë nga shkrija e bashkëtingëllores fundore të temës me mbaresën e formës vetore (-s + -sh > -ç).

Përkundrazi, mbaresa e vetës së tretë njëjës është shfaqur gjatë evolucionit të gjuhës shqipe. Ajo kumbon /-ë/ te foljet me temë në bashkëtingëllore (khs. të hap-ë, të dal-ë etj.). Por, kur tema foljore del në zanore, atëherë midis kësaj dhe mbaresës vetore /ë/, është shtuar një –j kundër hiatit (khs. të di-j-ë, të ve-j-ë etj.) Mirëpo, në veprën e Buzukut, vëren Demiraj (2015:309), te foljet me temë në zanore, në vend të mbaresës /ë/ shfaqet varianti /-e/ (khs. të ha-e, të di-e, të pi-e etj.). Nga këto dy variante, më e vjetër duhet të jetë /ë/. Por edhe kjo, dyshon Demiraj, se nuk mund të jetë shumë e hershme. Pas gjithë gjasash, ajo duhet të ketë qenë burimisht një zanore mbështetëse, e cila e ka marrë funksionin e mbaresës vetore pas rënies së mbaresës vetore të mirëfilltë të mëparshme.

Gjithashtu mbaresa vetore /ë/ në disa raste del e zgjeruar në trajtën /-një/ > /-jë/. Kështu p.sh. te Buzuku ka: Të mos mund-një, të kuor-një, të dëlir-një etj.; te Budi: Të hesht-një, të ikë-një etj. Duket qartë që në raste të tilla bëhet fjalë për zgjerimin e mbaresës /ë/ me /-nj-/, e cila, sipas Demirajt (2015), e ka burimin te koha e tashme e foljeve me temë në \*/-n-/ të tipit të zgjedhimit më \*/-jō/. Pra, /-një/ e ka burimin te forma e tipit të banj-ë / të bënj-ë nëpërmjet interpretimit të saj si të ba-një / të bë-një. Më pas kjo mbaresë, e zgjeruar me këtë mënyrë, është shtrirë me rrugë analogjike edhe te foljet me temë në bashkëtingëllore, siç ishte rasti i shembujve nga Buzuku, Budi e Matrënga.

Foljet, që në vetën e dytë e të tretë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore paraqiten me ndërrime morfonologjike, në të tashmen e lidhore në këto dy veta i kanë mënjeluar këto ndërrime nëpërmjet përgjithësimit të temës së vetës së parë njëjës. Kjo dukuri është pasojë e drejtpërdrejtë e prirjes për ta bërë edhe më të qartë dallimin midis së tashmes së lidhore dhe asaj të dëftores dhe për të mënjeluar njëkohësisht treguesit gramatikorë të tëpërt (rendulant) (Demiraj,2015).

## 2. SFONDI TEORIK

Temat e kohës së tashme të mënyrës lidhore, ashtu si të gjitha foljet e tjera, janë të njëjta me ato të mënyrës dëftore. Por në këtë pikë, ndërmjet tri foljeve të zgjedhimit atematik ka një ndryshim themelor: ndërsa te folja thom tema e lidhore së tashme është e njëjtë me atë të formave përkatëse të mënyrës dëftore (khs. thom – të thom, tha – të thuash, thotë - të thotë), në dy foljet e tjera, jam e kam, nuk ka përputhje ndërmjet temës së dëftores dhe lidhore; për foljen jam khs. jam – të jem, është – të jetë; për foljen kam khs. kam – të kem, ka – të ketë. Kjo dëshmon se format e lidhore të këtyre dy foljeve nuk janë ndërtuar nga format përkatëse të mënyrës dëftore, ashtu si te folja thom.

Sipas Topallit (2005), në vetën I numër njëjës ndryshimet ndërmjet mënyrës dëftore dhe lidhore lidhen me zanoren e brendshme dhe gjatësinë e saj. Ndërsa mënyra dëftore e ka zanoren –a, që është e shkurtër (jam, kam), mënyra lidhore e ka zanoren –e, që është e gjatë (të jem, të kem). Ai këtë e qartëson kur i përmend ato të folme që e kanë ruajtur gjatësinë e zanoreve, si p.sh., në gegërishte, te arbëreshët e diasporës etj.; Buzuku: E u të këndonj Tinëzot djerie të jem; Budi: Sā të jem gjall. Gjatësia e zanores në këto forma është në kundërshtim me rrokjet e mbyllura, që krijojnë përgjithësisht zanore të shkurtra. Për këtë arsye forma e vetës I me zanore të gjatë jem nuk mund të jetë vazhduese e një forme më të lashtë me zanoren –e, një \*jem, që në këtë rast do të dilte me zanore të shkurtër; si rrjedhim format e vetës I, sipas Topallit, janë ndërtuar nga një temë që dilte me zanoren –e fundore të gjatë. Kjo temë është forma e vetës II numër njëjës e mënyrës dëftore (jē, kē). Temat e këtyre formave vetore kanë krijuar më së pari format e vetës II numër njëjës, që dalin gjithashtu me zanore të gjatë (jē + -sh > (të) jēsh, kē + -sh > (të) kēsh) dhe pas këtyre, duke u shtrirë tema e vetës II në tërë paradigmen, janë ndërtuar edhe format e vetave të tjera, që për numrin njëjës janë: v. I jē + -m > (të) jēm, kē + -m > (të) kēm; v. III jē + -tē > (të) jetē, kē + -tē > (të) ketē. Kronologjikisht, veta II është ndërtuar më herët se veta I. Topalli (2015) mendon se me këtë rrugë formimi, si një ndërtim analogjik, mund të kuptohet edhe forma e vetës III pa fërkimore –sh-, që ka pasur kjo formë foljore në rrënjë të saj (ie. esti). Kështu, sipas këtij studiuesi, vetëm tema e vetës II numër njëjës është marrë nga mënyra dëftore duke shërbyer si temë e përbashkët për të gjithë paradigmen e kohës së tashme të mënyrës lidhore. Shihet se edhe në të tashmen e lidhore ka ndodhur e njëjta dukuri si në të tashmen e dëftores: shtrirja e një teme të caktuar në

tërë paradigmen. Por, megjithëse dukuria është e njëjtë, ajo është zhvilluar në kohë të ndryshme: më herët në paradigmen e së tashmes dëftore, që është formë më e përdorshme, dhe më vonë në paradigmen e lidhore.

Folja *thom* në vetën III numër njëjës, në disa të folme të Veriut e të Jugut del me mbaresën *-e*, prapa së cilës janë shtuar mbaresat e tjera vetore. Këtë formë, Topalli (2005) e ilustron duke sjellë shembuj nga Buzuku, i cili ka: *U të thoem korëset*; Budi: *Ndo pak ndo shumë të thoetë...* Sikurse shihet kjo formë, kjo mbaresë është shtuar në të gjitha format vetore, megjithëse ajo ka qenë mbaresë e një vete të caktuar, e vetës II numër njëjës, ashtu siç del në folje të tjera me temë në zanore, që marrin një mbaresë të tillë; p.sh.: te Buzuku: *E kuj Biri të doe me ja dhanë urtënë, aj ta die, kush t i mundë mbae tjetërë?* Por te folja *thom* mbaresa e vetës III është shtrirë në të gjithë paradigmen duke u bërë pjesë e temës dhe tipar dallues i temës së mënyrës lidhore, pas së cilës janë shtuar mbaresat vetore të këtij zgjedhimi. Me këtë proces kjo zanore ka pushuar së qeni mbaresë e një vete të caktuar (vetës III numër njëjës) dhe është shndërruar në një element organik të foljes, meqenëse dallimin e kategorive të vetës e të numrit e kryejnë mbaresat e tjera të zgjedhimit atematik. Por nëse te Buzuku që i ka ruajtur togjet zanore, kjo mbaresë dallohet qartë, në të folme të ndryshme që nuk i kanë ruajtur këto togje, kemi zanore të thjeshtë, që ka dalë nga tkurrja e dy zanoreve. Kështu dalin ato në disa të folme anësore të Jugut dhe në të folme të diasporës, ku folja *thom* në mënyrën lidhore del me zanoren *-e-* nga tkurrja /o/ + /e, ku /o/ - ja i përket rrënjës së foljes dhe /e/-ja është mbaresa e mënyrës lidhore; p.sh., në çamërishte: *të thet, të thenë* etj (Topalli,2005).

*Mënyra lidhore e foljeve të zgjedhimit të parë* (bëjnë pjesë foljet me temë në bashkëtingëllore, që e mbajnë atë të pandryshuar në të tria vetat e numrit njëjës të kohës së tashme, si: hap, çel, nis, mbledh, e edhe fpljet me ndryshime fonemash, si: dal, pjek) merr për temë formën e vetës I numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore duke e vënë si bazë të të gjitha formave vetore të së tashmes. Kjo duket qartë në klasën e foljeve që dalin me ndryshime zanoresh në temë (*khs. njoh - njeh, dal - del*), ku mënyra lidhore duke u ndërtuar mbi temën e vetës I numër njëjës, nuk i ruan këto ndryshime; *khs. njoh: të njoh – të njohësh – të njohë, dal : të dal – të dalësh – të dalë*. Kjo veçori shfaqet edhe në foljet e zgjedhimeve të tjera, ku kemi: *shes – shet*, por në lidhore *të shes – të shesësh – të shesë*, duke u shtrirë ndryshimi *-t - -s* i vetës I në të gjitha format vetore; ose *banj – ban*, por në lidhore *të banj – të banjësh – të banjë*, duke u shtrirë fundorja *-nj* e vetës I në të gjitha format vetore. Dukuria në këtë rast është e kundërt me foljet e zgjedhimit atematik, të cilat mënyrën lidhore e ndërtojnë mbi temën e vetës II numër njëjës (*khs. jë – të jëm, përkundrejt jam*).

Topalli (2005) thotë se në vetën II numër njëjës, lidhja e temës me mbaresën bëhet përgjithësisht duke ndërkallur zanoren *-ë* (*të hap-ë-sh*). Kjo zanore në shumë të folme është shndërruar në *-i*; p.sh.: *Njekto t'gjallët t'm'i falish mue*. Përmend këtu edhe Buzukun, p.sh.: *Ti të nderish të tū përingd*. Por te shkrintarët e vjetër dhe nëpër dialekte dalin edhe forma pa këtë zanore duke u lidhur tema e foljes drejtpërdrejt me mbaresën, me të cilën krijon një grup bashkëtingëllor; p.sh., Buzuku: *Ti të nxjerrsh shpirtinë tem n mundimeshit*. Matrënga: *Të japsh të hāanë të vabëgjet të urëtë*.

Një formë tjetër e mënyrës lidhore është ajo që ka marrë mbaresën *-nj* të foljeve të zgjedhimit të tretë, që është zgjedhimi më aktiv i gjuhës shqipe; p.sh., Buzuku: *E ti, i mallëkuom dreq, të iknjësh...* Matrënga: *Të veshnjësh të xheshuritë*. Sikurse shihet, dukuria ka përfshirë të dy dialektet.

*Mënyra lidhore e zgjedhimit II* (përfshihen foljet me bashkëtingëllore dhëmbore *-t*, që e këmbejnë me fërkimoren *-s* në vetën I numër njëjës, si: *mas-mat, rris-rrit, pres-pret, lus-lut* etj) formohet duke marrë për bazë vetën I numër njëjës të mënyrës dëftore, që del me fërkimore (*shes*). Kjo formë është shtrirë edhe në dy vetat e tjera duke mënjanuar format me *-t* (*khs. të shesësh – të shesë*). Por format e numrit shumës dalin identike me vetat përkatëse të mënyrës dëftore, si rrjedhim, në vetën II shfaqet bashkëtingëllojia *-t* (*të shitni*); kurse forma *të shisni* e kësaj vete është më e re, dhe, ashtu si në mënyrën dëftore, është ndërtuar me rrugë analogjike nga dy vetat e tjera të shumës për ta njësuar temën në tërë paradigmen.

Por ndërmjet foljeve të nënklasës së parë (*mas*) dhe të dytë (*shes*), Topalli (2005) thekson një ndryshim në ndërtimin e mënyrës lidhore: ndërsa foljet e nënklasës së parë në vetën II përdorin forma me fërkimoren *-s* dhe me dhëmboren *-t* (*të masësh e të matësh, të masë e të matë*), foljet e nënklasës së dytë përdorin vetëm forma me fërkimoren *-s* (*të shesësh, të shesë*). Kjo dukuri lidhet me rrugët e ndërtimit të këtyre formave. Ndërsa foljet e nënklasës së parë kanë ndjekur dy rrugë për ndërtimin e lidhore, njëra nga tema e vetës I (*mas: të mas, të masësh, të masë*) e tjetra nga vetat përkatëse të mënyrës dëftore (*mas : të mas, mat : të matësh, mat : të matë*); foljet e nënklasës së dytë kanë ndjekur vetëm rrugën e parë duke u shtrirë forma e vetës I edhe në vetat e tjera (*shes : të shesh – të shesësh – të shesë*).

*Foljet e zgjedhimit të tretë mënyrën lidhore* (përfshihen foljet që në vetën I numër njëjës dalin me mbaresën *-nj*, kurse në vetën II e III dalin me mbaresën *-n*) e ndërtojnë përgjithësisht duke u mbështetur në temat e mënyrës dëftore. Kjo duket qartë sidomos në vetën I numër njëjës, ku kemi: *bënj – të bënj, shkonj – të shkonj*. Por problemi ndryshon në vetën II e III që marrin mbaresa të veçanta. Në këto veta janë krijuar disa forma, që mbështeten në tema të ndryshme e me lidhje jo të njëjta me mbaresën. Njëra formë është ajo që mbështetet në temën pa mbaresë të

foljes, që si e tillë del në mënyrën urdhërore, në disa folje edhe në pjesore; p.sh.: *bã/bë – të bësh, shko – të shkosh, kthe – të kthesh*. Mbaresa vetore në këto forma lidhet drejtpërdrejt me temat foljore. Një formë e dytë është krijuar duke u mbështetur në temën e vetës I, ku është përfshirë edhe mbaresa *-nj*, dhe për lehtësi shqiptimi ka ndërhyrë zanorja *-ë* në grupin bashkëtingëllor që krijojnë dy mbaresat, njëra me burim nga veta I (*-nj*) edhe tjetra mbaresa vetore e lidhore (*-sh*). Këto forma i ruajnë shkrimtarët e vjetër, p.sh.: Buzuku: *Qi tit a banjësh me vetëhenë përpara shkambit tinë* (Topalli 2005).

*Zgjedhimi i katërt* i foljeve tematike paraqitet heterogjen në përbërje, meqenëse në të janë bashkuar grupe foljesh me origjinë të ndryshme, që kanë ndjekur rrugë të ndryshme derisa kanë përfunduar me temë në zanore (përfshihen foljet, si: pi, di, ngre, shpie, shtie etj.). Mbaresat e vetës së dytë dhe të tretë dalin njëjtë si ato të zgjedhimit të parë. Te Buzuku, veta II, numri njëjës del kështu në këtë fjali: Le të dësh, i mallëkuom dreq. Sipas Topallit (2015), zanorja e gjatë e kësaj forme është në kundërshtim me rrokjen e mbyllur që krijon mbaresa *-sh*, si dhe me formën përkatëse të mënyrës dëftore që del me zanore të shkurtër, prandaj, thotë ky studiues, se ajo është krijuar duke u marrë si bazë tema e vetës I numër njëjës.

### 3. PËRFUNDIMI

Në përgjithësi, kategoria gramatikore e mënyrës ka pësuar shumë ndryshime në forma dhe funksione në krahasim me gjendjen e vjetër indoevropiane.

Mënyra lidhore ka pësuar një evolucion të shumanshëm, dhe faktorët për këtë zhvillim kanë qenë të ndryshëm. Demiraj përmendte prirjen e gjuhëve ballkanike për ta përdorur lidhoren edhe nëpër fjali të nënrenditura, kryefjala e të cilave në shumë raste ndryshon nga ajo e fjalisë kryesore. Kështu, në shqipen e dokumentuar ajo përdoret më shpesh nëpër fjali të varura. Por, po ashtu format e lidhore, sidomos të së tashmes, përdoren edhe në fjali kryesore, apo edhe pas foljeve modale *mund* dhe *duhet*. Një përdorim i tillë ndeshet në të dyja të folmet, jugore dhe veriore, për të cilin thuhej se ishte relativisht i vjetër (Demiraj, 2015), meqë gjendej edhe te autorët e vjetër, si Buzuku, Budi etj.

Folja *jam* në të gjithë paradigmen e së tashmes së lidhore del me temën burimore *je- < \*es-*. Kjo paraqitje e temës *je-* në të gjithë paradigmen e lidhore, sipas studiuesve duhet kërkuar në prirjen relativisht të vjetër të shqipes për t'i rrafshuar ndryshimet në temën e kësaj forme kohore. Mbaresat vetore të kohës së tashme të kësaj mënyre të zgjedhimit atematik, në përgjithësi, janë të njëjta me ato të së tashmes së dëftores. Përfundim bën prania e mbaresës së vetës së dytë njëjës *-sh*, e cila e ka burimin te mbaresa vetore i.e. *\*-si*, si dhe shtrirja analogjike e mbaresës *-të* te *të ke-të*, sipas *të je-të*. Ndërsa mbaresa e vetës së tretë njëjës është *-ë*, e cila është shfaqur gjatë evolucionit të shqipes.

### BIBLIOGRAFIA

- Altamari F. (2014). Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian. Prishtinë: ASHAK.  
Bokshi, B. (2010). Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes. Prishtinë: ASHAK.  
Bokshi, B. (2011). Format e futurit të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit. Prishtinë: ASHAK.  
Beekes, R. (1995). Comparative indo-european linguistics. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.  
Çabej, E. (1986). Studime gjuhësore (VII). Prishtinë: Rilindja.  
Demiraj, Sh. (1975). Morfologjia historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.  
Demiraj, Sh. (1988). Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.  
Demiraj, Sh. (2004). Gjuhësi Ballkanike. Tiranë: ASHSH.  
Demiraj, Sh. (2015). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.  
Demiraj, B. (2011). E ardhmja e tipit do+lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe. Prishtinë: ASHAK.  
Fiedler, W. (2011). Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë. Prishtinë: ASHAK.  
Likaj, E. (2005). Fleksioni indoevropian. Tiranë: ShBLU.  
Likaj, E. (2014). *Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes*. Tiranë: ASHSH.  
Mansaku, S. (2011). Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes. Prishtinë: ASHAK.  
Rugova B. – Sejdiu L. (2015). Hyrje në gramatikë teksti në gjuhën shqipe. Prishtinë: Trembelat.  
Topalli, K. (2012). Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.  
Topalli, K. (2010). Sistemi foljor i shqipes. Tiranë: Plejad.